



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 18/2 Prot.

Tiranë, më 02/6/2011

Lënda: Rekomandim për **Porti Detar sh.a Vlorë**.

REKOMANDIM

Mbështetur në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, **Porti Detar sh.a Vlorë**,

KONSTATOVA

Më datë 19.04.2011 nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar hetimi administrativ pranë kontrolluesit, **Porti Detar sh.a Vlorë**, me cilësinë si kontrollues që mbledh dhe përpunon të dhëna personale në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit të tij, me objekt:

- Zbatimi i kushteve dhe kriterëve të parashikuara në nenet 5,6,7,8, të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.
- Zbatimi i të drejtave të subjekteve të të dhënave personale.
- Siguria e të dhënave personale, masat për sigurinë e të dhënave personale.
- Njoftimi i të dhënave që përpunohen.
- Si zbatohen rregullat e konfidencialitetit për përpunimin e të dhënave personale.
- A përpunohen të dhëna personale nëpërmjet sistemeve të kamerave (CCTV), nëse ka tabela informuese.

